



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.6, datë 07.12.2022

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES  
NR.30/2 PROT., DATË 7.8.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN NR.24,  
DATË 31.7.2017 “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR KURATIV,  
MINERAL, TERMOMINERAL DHE GJEOTERMAL (LLIXHA),  
SUBJEKTIT “MARJETA KËRCYKU”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të lejes nr.30/2 prot., datë 7.8.2017 miratuar me vendimin nr.24, datë 31.7.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin si më poshtë:

Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)

Nga: X= 507387.5; Y= 4542871.9; Z= 127 m.m.n.d

Në: X= 507387.5; Y= 4542871.9; Z= 227 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.0003 m<sup>3</sup>/s

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.30/2 prot., datë 7.8.2017 miratuar me vendimin nr.24, datë 31.7.2017 të Këshillit të Basenit Ujor

Shkumbin për “Përdorim burimi ujqor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal (Ilixha)”.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

